



**Organizata Jo-Qeveritare Emancipimi Civil Ma Ndryshe
EC MA NDRYSHE**

30 dhjetor 2016, Prizren

**Komunikatë për media
Raste simbolike të ndjekjes për ndërtimet pa leje dhe dëmtimin e Trashëgimisë Kulturore**

Organet e drejtësisë janë aktivizuar sa i përket shqyrtimit të rasteve që kanë të bëjnë me ndërtime pa leje dhe dëmtimin e Trashëgimisë Kulturore në Prizren, ani pse statistikat e tremujorit të tretë të vitit 2016 janë simbolike në këtë drejtim.

Në tremujorin e tretë të vitit 2016, Gjykata Themelore e Prizrenit lidhur me ndërtimet pa leje dhe dëmtimin e Trashëgimisë Kulturore ka raportuar se në departamentin e përgjithshëm ka 2 lëndë në procedurë gjyqësore, derisa te krimet e rënda ka 1 lëndë në procedim sa i përket trashëgimisë kulturore.

Prokuroria Themelore e Prizrenit në raportin statistikor lidhur me ndërtimet pa leje, tejkalimet e lejeve, rrënimet e dëmtim të monumenteve në Qendrën Historike të Prizrenit ka paraqitur se i ka pas në punë nga periudhat paraprake 11 kallëzime penale ndaj 17 personave, derisa në tremujorin e tretë nuk ka pranuar asnjë kallëzim penal. Nga lëndët që i ka pas në punë në 3 kallëzime janë ngrit 3 aktakuza ndaj 3 personave, kanë filluar hetimet në një kallëzim ndaj 6 personave dhe janë hedhur poshtë 2 kallëzime ndaj 2 personave. Kanë ngelë në punë 6 kallëzime ndaj 12 personave.

Inspektorati i Komunës së Prizrenit gjatë tremujorit të tretë ka evidentuar dy raste të ndërtimeve pa leje, një nga Kisha Ortodokse Serbe dhe një nga një pronar privat, me ç'rast ka proceduar me dënime mandatore dhe inicim të procedurës gjyqësore për vepër penale në Gjykatën Themelore të Prizrenit.

Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor gjatë kësaj periudhe ka proceduar 12 lëndë në QRTK dhe KTK, dhe vetëm një lëndë vetëm në QRTK. Urbanizmi ka raportuar se në asnjë rast nuk lëshohet leja pa pëlqimin e autoriteteve të Trashëgimisë Kulturore.

QRTK-ja pohon se janë lëshuar 11 pëlqime, në bazë të vendimeve të IMMK-së, derisa pa shqyrtimin e QRTK-së janë evidentuar 3 objekte.

MMPH-ja ndërsa ka raportuar se gjatë kësaj periudhe ka realizuar një inspektim sipas ankesës rreth ndërtimit të objektit të banimit individual në Qendrën Historike të Prizrenit, dhe me vendim ka kërkuar nga DUPH-ja pezullimin e lejes ndërtimore. Organi komunal e ka respektuar urdhrin e inspektoratit të MMPH-së.

EC Ma Ndryshe përsërit qëndrimin se fakti që organet e drejtësisë kanë nisur adresimin e parregullsisve urbanistike është inkurajues, por se megjithatë ka ende shumë punë për t'u bërë në këtë drejtim. Madje edhe koordinimi më i afërt mes institucioneve të shtetit, të pushteteve të ndryshme, është i domosdoshëm për të vendosur rend urbanistik në Qendrën Historike dhe pjesët tjera të qytetit.

Në të njëjtën kohë, EC thekson se me legjislacionin në fuqi dëmtimi ose shkatërrimi i trashëgimisë kulturore përbën vepër penale dhe se politikat ndëshkimore duhet të aplikohen në mënyrë që të parandalohet degradimi si në Qendrën Historike të qytetit ashtu edhe në pjesët tjera të qytetit.

Projekti "Transparenca e Planifikimit Hapësinor në Prizren" synon hapjen e dokumenteve të planifikimit hapësinor në komunën e Prizrenit, për të përmbushur obligimet e Kartës për Hapjen e të Dhënave, dhe rritur nivelin e llogaridhënies publike në këtë sektor. Hapja e të dhënave dhe dokumenteve të planifikimit hapësinor do të krijojë mundësi më të mëdha për mbikëqyrjen e punës së autoriteteve publike në raport me urbanizmin, lejet e ndërtimit, planifikimin zhvillimor dhe menaxhimin e trashëgimisë kulturore.

Me nderime,
Valon Xhabali, Koordinator i Projektit
OJQ EC Ma Ndryshe
Bulevardi Nëna Terezë 30B H-I-5, 10000 Prishtinë
www.ecmandryshe.org & info@ecmandryshe.org
+381 38 224 967 & +381 29 222 771

Projekti "Transparenca e Planifikimit Hapësinor në Prizren" përkrahet financiarisht nga Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur (KFOS).

SOROS
Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur
Kosovo Foundation for Open Society
Kosovska Fondacija za Otvoreno Društvo